

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“FIF OIL ” SH.P.K

Ne baze te ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”
“NE” ortakët e poshteshenuar :

- 1- **ILIR SHAMETI** , atesia Abedin, i dtl. 05.12.1971, lindur në Kuç/Skrapar, banues në Tiranë, identifikuar me kartën ID nr. H 11205083G madhor dhe më zotësi të plotë juridike për të vepruar Vaso pasha , pallati nr.5, h.1. K6. Tirane
- 2- **IBRAHIM MOHAMED MAKI** atesia MOHAMED lindur me 06.09.1968 ne qytetin e KHARTOUM -SUDAN banues ne adresen “Rruga Thanas Ziko nr 4 TIRANE i identifikuar me pasaporten e Republikës së SUDAN-it nr.P11770864
- 3- **AFIFELDIN ELMOSCHARAF ABDELRAHMAN ELMOSCHARAF** atesia **ELMOSCHARAF** lindur me 01.01.1953 ne qytetin e HASSAHISSA -SUDAN banues ne SUDAN ne adresen: Qyteti Khartoum , Lagja Jerif West, rruga Alhara Alawla B , ap nr.112, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me pasaporten e Republikës së SUDAN-it nr P09729062

me vullnetin tone te lire e te plote themelojme me ane te ketij statusi shoqerine **“FIF OIL” SH.P.K me 3-(tre) ortak** sipas dispozitave ligjore te shprehura me poshte ne baze te ligjit 9901 Dt.14.04.2008.

KREU I

THEMELIMI, EMRI,OBJEKTI,KOHEZGJATJA,SELIA,ADRESA NE INTERNET

Neni 1

Themelimi dhe Emri i Shoqerise

Sot ne date 08/11/2024, ne Tirane, “NE” ortakët e lartpermendur kemi themeluar shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“FIF OIL ” SH.P.K me 3-ortak**) me SELI QENDRORE ne adresen **“Tirane , “Tirane rruga Irfan Tomini , NR.PASURISE1/301+1-16 ZK.8260 VOL 34, FQ.36, h 1, Ap.16 ” Tirane-Shqiperi.”**

Neni 2

Objekti i Shoqerise

Shoqeria tregtare **“FIF OIL ” SH.P.K** , do te kete si objekt te veprimtarise se saj :
Aktivitet tregtar si komisioner ne fushen e ndermjetesimit ndermjet shitesit dhe blesesit ne cdo aktivitet tregtar te ligjshem qe ka te beje me tregtimin ne produktet e naftes se perpunuar, naftes bruto dhe neperprodukteve te tyre. Pjesemarrja ne kapital, aktivite tregtare ne fushen e prodhimit, importit , eksportit, distribucionit, shperndarjes, eskluзивitetit, francizes, shitjes me shumice e pakice te mallrave te te gjitha llojeve. Krijimin e partneriteteve nepermjet bashkepunimit me shoqeri te ndrsyhme brenda dhe jashte Shqiperise per ndermjetesimin e shitjes apo blerjes se te gjitha llojeve te naftes e nenprodukteve te saj. Aktivite ne fushen e investimeve ne fusha te



ndryshme, aktivitete komisioni dhe broker dhe aktivitete agjensie dhe agjenti. Te kryej cdo transaksion me pasurit e luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar financiar, dhenie marrje me qera dhe te vendos pengje dhe barre hipotekore. Te bleje ne menyre direkte ose indirekte kuota te shoqerive te tjera ne shqiperi ose jashte saj. Te kryej aktivitete publikimi dhe reklamimi.

Neni 3

Kohezgjatja e Shoqerise

Shoqeria do te kete nje afat te papercaktuar ne veprimtarine e saj . Personalitetin juridik shoqeria e fiton pas rregjistrimit ne QKB , date e cila do shenoje dhe fillimin e veprimtarise se saj.

Neni 4

Selia qendrore , vendi dhe adresa e Internetit

Selia qendrore e shoqerise, me te cilin do te pajiset me Nipt/Nuis kryesor nga Qkb-ja, do te jete ne adresen adresen: **“Tirane rruga Irfan Tomini , NR.PASURISE1/301+1-16 ZK.8260 VOL 34, FQ.36, h 1, Ap.16 ” Tirane-Shqiperi.”**

Shoqeria ne baze te ligjit ka te drejte te hape zyra perfaqesimi ose dege te saj ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë vendit, duke ju nënshtruar legjislacionit të vendit perkates. Shoqeria gjate veprimtarise se saj ka te drejte qe te kete maredhenie edhe me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja, brenda dhe jashte vendit, te beje bashkepunime me to ne baze te ligjeve shteterore dhe atyre nderkombetare. Shoqeria ka dhe adresen e saj ne internet qe eshte **ilir.shameti@gmail.com**

KREU II

Neni 5

Kapitali i Rregjistruar i Shoqerise

Kapitali i rregjistruar i shoqerise eshte **150,000 (njqind e pesedhjetë mijë) leke** dhe perbehet nga **“3” (tre)** kuota/pjese. Secili ortak i shoqerise zoteron nga **“1”** kuote secili dhe kapitali i shoqerise zoterohet teresisht nga 3-ortaket.

Ortaku **ILIR SHAMETI** zoteron 33.34% te kapitalit themeltar te shoqerise ose 1-nje kuote me vlere 50,000(pesedhjetë mijë) , ortak **IBRAHIM MOHAMED MAKI ELFAKI** zoteron 33.33% te kapitalit te shoqerise ose 1-nje kuote me vlere 50.000(pesedhjetemije) leke., ortak **AFIFELDIN ELMOSHARAF ABDELRAHMAN ELMOSHARAF** zoteron 33.33% te kapitalit te shoqerise ose 1-nje kuote me vlere 50.000(pesedhjetemije) leke.

Pas rregjistrimit ne QKB dhe fitimit te personalitetit juridik, shoqeria ka te drejte te perdore kapitalin e rregjistruar per fillimin e veprimtarise se saj. Shoqeria mund te marre hua financiare nga persona fizik ose juridik, institucione Bankare vendas ose te huaj, ne perputhje me ligjin e brendshem ose ate nderkombetar, per te plotesuar vleren financiare nese kapitali financiar eshte i pamajftueshem per fillimin e aktivitetit.

Neni 6

Certifikata dhe rregjistri i KUOTAVE

Ortaket themelues , sipas kontributit ne kuotat e kapitalit themeltar pajisen me Certifikaten e Kuotave leshuar nga shoqeria menjehere pas fitimit te personalitetit te saj juridik pas rregjistrimit ne QKB. Kuotat e shoqerise rregjistrohen ne “Rregjister” me vleren e tyre, rregjister qe administrohet nga administratori i shoqerise gjate gjithë mandatit te tij ligjor te vendosur ne ligj

El

dhe ne kete Statut . Ne kete rregjister behen shenimet perkatese ne rast te tjetersimit teresisht ose pjeserisht te koutave te kapitalit themeltar te shoqerise ose kur kouta te caktuara zoterohen bashkarisht nga disa ortak.

Neni 7

Kalimi i KUOTAVE

Kalimi ose tjetersimi i kuotave te kapitalit themeltar te rregjistruar te shoqerise mund te behet me anen e shitblerjes , dhurimit, trashegimit ose cdo menyre tjeter te perashikuar ligjerisht. Ne rastet e shitblerjes apo dhurimit nenshkruhet kontrata perkatese ne baze te dispozitave ligjore. Secili prej ortakeve eshte i detyruar te marre pelqimin e ortakut tjeter para se te bej kalimin e pjeses se tij te kuotave tek nje person tjeter fizik ose juridik qe pretendon te hyje si ortak i ri ne shoqeri. Ne rastet kur nje ortak vdes, atehere kuotat e tij trashegohen ne baze te ligjit per shoqerite tregtare dhe te dispozitave ligjore per trashegimine nga pasardhesit e tij sipas radhes ligjore ose testamentit. Trashegimtari i kuotave pasi i ka paraqitur administratorit dokumentat provuese si trashegimtar, ka te drejte te kerkoje nga administratori rregjistrimin e emrit te tij si ortak ne rregjistrin e kuotave te shoqerise. Sido qe te jete menyra e kalimit te kuotave, Administratori ne cdo rast ben shenimet perkatese ne rregjistrin e aksioneve.

Neni 8

Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit te shoqerise

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët ne te njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë. Asambleja e Ortakeve merr vendimin perkates ne baze te dispozitave te ligjit tregtar, ku vendos per shumen me te cilen do te rritet kapitali dhe autorizon administratorin te ndjeke te gjitha procedurat ligjore per kete qellim. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njëjtat kushte qe kërkohen per ndryshimin e statutit. Zvoglimi i kapitalit te shoqerise behet me vendim te asamblese dhe ne cdo rast jo me pak se 100.000(njeqind- mije) leke sipas kushteve ligjore te parashikuara ne ligj. Ne cdo rast zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit behet me nje raport te detajuar te ekspertit kontabel dhe rregjistrohet ne QKB. Asambleja e ortakeve vendos per rritjen apo zvoglimin e kapitalit mbasi eshte konsultuar me ekspertin kontabel ne baze te nje raporti te detajuar te tij, si dhe me administratorin.

KREU III

ORGANET DREJTUESE Asambleja , Administratori

Neni 9

Asambleja

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e ortakeve, mblidhet ne menyre te zakonshme te pakten 2-here ne vit. Mbledhja thirret nga te pakten njeri prej ortakeve ose dhe nga administratori. Njoftimi behet te pakten 7-dite para dates se caktuar per mbledhje me ane te faxit, telefonit fix apo cel, rrjeteve sociale, e-mailit, postes etj.

Asambleja (ortaku) merr vendime dhe ka kompetenca per :

Fel



- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; per investime;
 - vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
 - përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - ndryshimet e statutit;
 - emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur me lart
 - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
 - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ne raste te caktuara kur nje nga ortaket mungon ai mund te perfaqesohet sipas rregullave ligjor te perfaqesimit nga nje person i zgjedhur prej tij.

Neni 10

ADMINISTRATORI

ADMINISTRATORI i emeruar i shoqerise me vendim unanim te asamblese se ortakeve eshte Zoti **ILIR SHAMETI**. Afati i emerimit te tij eshte 5-vite me te drejte rizgjedhjeje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me shumice votash nga asambleja e ortakeve.

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet qe të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare, kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori i shoqerise ka te drejte te kryeje veprime financiare ne te gjitha Bankat ku Shoqeria ka llogari Bankare ne menyre te lire e te pa percaktuar ne monedhen "leke" "dollar amerikan" euro" ose sipas konvertimit te lekut me monedhen e huaj sipas kursit te Bankes se Shqiperise. Administratori ne baze te ligjit mund te delegoje nje ose disa kompetenca te veprimtarise se tij tek nje person tjetër me ane te autorizimit ose prokures.

Administratori eshte personi qe perfaqeson shoqerine me te tretet dhe specimenti i nenshkrimit te tij eshte si me poshte :

El

Specimenti /nenshkrimi

Ilir Shumeti

Neni 10

Emerimi I ekspertit kontabel

Asambleja e shoqërisë cakton një ose disa eksperte kontabel që mund të jenë persona fizik ose juridik, në rastet e kerkuara nga ligji. Mandati i ekspertit kontabel është **3-vjet** me të drejtë rizgjedhjeje. Emerimi dhe largimi i ekspertit bëhet me vendim të asamblese me shumicë të thekshtë. Eksperti kontabel ka detyrimin të raportoje ecurinë financiare të shoqërisë dhe të bëjë sugjerime për rentabilitetin e veprimtarisë së shoqërisë. Eksperti kontabel ka të drejtë të bëjë kontrole periodike të aktivitetit të shoqërisë dhe të raportoje për këto tek ortaket ose administratori. Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor. Eksperti kontabel mban një raport të detajuar në mbylljen e vitit ushtrimor fiskal dhe është përgjegjës për mbylljen e bilancit të shoqërisë dhe ndarjen e dividendit. Dividendi shpërndahet mes ortakëve, në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, dhe kuotat e secilit ortak.

Neni 11

Dividentet dhe shpërndarja e tyre.

Shpërndarja e dividendit bëhet pas raportit financiar të ekspertit për mbylljen e vitit ushtrimor financiar, bilancit. Shpërndarja bëhet me vendim të ortakut ose të asamblese në përputhje me ligjin. Shpërndarja e dividendit bëhet në raport me pjesëmarrjen e ortakut-ve në kuotat e kapitalit të regjistruar. Një pjesë e dividendit të pashpërndarë, me vendim të asamblese mund të kalojë në kapitalin themeltar.

Neni 12

Riorganizimi, Prishja dhe likuidimi I shoqërisë

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" Në rastet e prishjes dhe të likuidimit të shoqërisë para afatit të mesipër vendos mbledhja e përgjithshme e asamblese së ortakëve. Likuiduesi mund të shpërndajë të ortakut-ët të gjitha pasuritë e deri në atë moment që posedon në pronësi shoqëria. Prishja mund të vijë edhe si pasojë e falimentimit të shoqërisë. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e ortakëve ose ortakut i vetëm. Nëse asambleja nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Likuiduesi emërohet nga Gjykata në rastet kur shoqëria prishet me vendim gjykatës. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakut-ve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura,

fel

Ilir Shumeti

likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

Neni 13

Dispozita te Fundit

Ky "Statut" është mbështetur teresisht në ligjin 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare". Për të gjitha rastet të cilat nuk janë parashikuar në statut do të gjejnë zgjidhje dhe interpretohen sipas këtij ligji. Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregëve, do të jetë kompetente Gjykata Kompetente Shqiptare.

"Statuti" është përpiluar në 4-kopje origjinale me fuqi të njëjta ligjore, në gjuhën SHQIPE sipas kërkesave të ligjit. Përmbajtja e STATUTIT pasi lexohet dhe kuptohet përfundimisht mesemiri nga të gjithë ortaket e shoqërisë të cilët flasin, kuptojnë dhe shkruajnë në gjuhën Shqipe gjendet në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe "Ne" ortaket e sipershënuar e nënshkruajnë pa asnjë vërejtje. Ky STATUT përket në gjuhën që kuptojnë ortaket dhe i lexohet atyre në gjuhën që kuptojnë dhe pasi ata deklarojnë se kuptuan dhe gjithshka është sipas vullnetit të tyre e firmosin pa asnjë vërejtje.

THEMELUESIT E SHOQËRISË "FIF OIL" SH.P.K

ILIR SHAMETI

Ilir Shameti

IBRAHIM MOHAMED MAKI ELFAKI

Ibrahim Elfaki

AFIFELDIN ELMOSHARAF ABDELRAHMAN ELMOSHARAF

AFIF ELDIN ELMOSHARAF ABDELRAHMAN ELMOSHARAF